



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit- Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit

REPUBLICA E KOSOVË KOMUNA GLLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		06/06/	2024
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/01-27277		

Në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, përkatësisht nenit 9, pika 1.3, dhe Vendimit nr.02-400/01-57202 të datës 22.11.2023, thirret mbledhja e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

F T E S Ë

Për anëtarin/ën _____, nga _____
që të marrë pjesë në mbledhjen e rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), lidhur me zhvillimet në Komunën e Drenasit. Mbledhja e rregullt do të mbahet më datën 13.06.2024, ditë e enjte, nga ora 14:00, në Sallën e Kuvendit Komunal në Drenas.

Rendi i ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 18.04.2024, <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/procesverbal-i-dates-18-prill-2024/>;
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit;
3. Informim për fushatën "Bashkë për pastërtinë e komunës së Drenasit- zemrën e Kosovës";
4. Të ndryshme

Kopje: Anëtarëve të KKSB-së



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci



KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		03/07/2024	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
07	060/09	-	31347

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

Komuna / Opština: Drenas Data / Datum: 13.06.2024

Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 3

Takim i rregullt / Redovni sastanak Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak

Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 16

A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së?

Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?

Po / Da

Jo / Ne

Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice

A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së?

Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?

Po / Da

Jo / Ne

Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë

Konkluzionet / Zaključci:

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) ka mbajtur mbledhjen e tretë për këtë vit ku të pranishëm ishin 16 anëtarë të KKSBB-së që përfaqësojnë komunitet dhe organizatat në komunën e Drenasit dhe drejtorë të drejtorive komunale. Mbledhja u udhëheq nga nënkryetari i komunës, z. Arben Shala.

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur me datë 18.04.2024, <https://kk.rks.gov.net/glllogoc/procesverbal-i-dates-18-prill-2024/>. Procesverbali u miratua pa ndonjë vërejtje nga anëtarët e KKSBB-së.

2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit. Për gjendjen e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Drenasit raportoi Komandanti i Stacionit Policor në Drenas, z. Driton Morina. Ai theksoi se gjendja e sigurisë është e qetë, pra pa raste përveç disa më të zakonshme, por që shqetësuese mbetet sigurisht gjendja në trafik. Ai përmendi rasti e vetaksidentit në Dobroshec me motor. “Problematikë aktualisht është përdorim i motoreve, përkatësisht prej trotineteve e deri te mjetet motorike me katër rrota. Ne kudo që vërejmë dhe marrim informacione për vozitje të rrezikshme me motor, po ndërmarrim masa. Për këtë problematikë që sigurisht në Drenas nuk është shumë e shqetësuar situata por e pranishme, duhet të reagojmë secili nga pozitë që përfaqësojmë”, ka theksuar mes tjerash Morina. Ai njoftoi për statistikën e aksidenteve që këtë vit është 106 aksidente, ndërsa për periudhën e njëjtë vitin e kaluar kanë qenë 97 aksidente.

Lidhur me këtë pikë, përfaqësuesi nga bashkësia fetare katolike, Meriton Sopi ngriti shqetësimin e lëvizjeve të shpeshta me motor të disa grupeve në pjesën e fshatit Llapushnik, te ‘Bokat’, sidomos gjatë vikendeve. Ai kërkoi që të shtohen patrullimet në atë pjesë. Për këtë shqetësim të ngritur, Komandant Morina theksoi se mundën të shtojnë patrullimet, por edhe kur ka vozitje të rrezikshme raportoni në Polici dhe do të ndërmarrin masa.

3. Informim për fushatën “Bashkë për pastërtinë e komunës së Drenasit- zëmrën e Kosovës. Lidhur me këtë pikë, Drejtori për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Nexhmedin Gruda njoftoi të pranishmit për aksioni e pastrimit në Komunën e Drenasit. “DSHP ka ndërmarr aksion për pastrimin nga mbeturina të mjedisit në Drenas, aksion ky që është mirëpritur. Në këtë aksion janë bashkangjitur edhe Inspektorati i Mbrojtës së Mjedisit në kuadër të Ministrisë, ku i kanë hequr tri deponi të mëdha. Edhe dy shkollat e mesme i janë bashkangjitur dhe të gjitha shkollat disa orë i kanë kushtuar pastrimit të zonave përreth shkollave. Gjithashtu edhe OJQ si CEDE kanë shprehur gatishmëri për pastrim të Liqeni i Vasileves si dhe jemi në bisedime me administratorët e fshatrave për caktimin e një dite vikendi për pastrim nëpër vendbanime”. Ai theksoi problemin e djegies së mbeturinave nëpër depo të mbeturinave inerte ku po hedhen edhe të tjera mbeturina.

Te kjo pike, Arben Haziri nga Këshilli i Prindërve ngriti problemin me korrjeshirjet përkatësisht djegia e arave që bëhet nga persona të papërgjegjshëm. Lidhur më këtë shqetësim, Drejtori Gruda theksoi se tashmë kanë diskutuar me zjarrfikësit ku do të ngritët kapacitetet ndërsa do të ndihmoj edhe kompania e pastrimit me ujë.

Te ndryshme:

Te pika ‘Të ndryshme’, Nënkryetari. Shala informoi anëtarët se kërkesa për krijimin e një nënstacioni policor në Komoran që ka dalë nga KLS është në procedurë, dhe po presin ligjshmërinë nga MAPL.

Përfaqësuesi nga Bashkësia Fetare Myslimane, Eset Bajraktari kërkoi nga komandanti i Policisë z. Morina që ketë patrullime ditën e Kurban Bajramit, përkatësisht kur bëhet falja e namazit tek xhamitë që janë afër rrugës për shkak të lëvizjeve më të mëdha në atë orë. Pra, të shtohet kujdesi.

Arben Haziri ngriti shqetësimin për sigurimin e teksteve shkollore që sipas tij shumë prindër nuk kanë qasje në sistemin e E-Kosova për tërheqjen e mjeteve dhe blerjen e teksteve për fëmijët.

Arben Nika ngriti shqetësim lidhur me pustetat nëpër trotuare që shumë po dëmtohen nga OE të cilët punojnë dhe nuk i mbyllin/rregullojnë. Si dhe mundësinë që të krijohet grup punues komunal kryesisht për djegien me hapë rezervarë të ujit, dhe me shiku mundësinë e aplikimet për fonde për mjedis si nga BE të cilët kanë fonde për 'përshtatje të ndryshimeve klimatike'. Nexhmedin Gruda lidhur me këtë çështje theksoi se menaxhimin e pusetave e ka kompania e ujësjellësit KRU Prishtina, dhe që çdo ditë përballen me problem të tilla ku edhe vet si DSHPE janë të angazhuar dhe i dalin në ndihmë.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSB-së:
Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: **Laureta Thaqi**
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari: **Ramiz Lladrovci**

Izveštaj odobrava Gradonačelnik:

Nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobravanja: **03.07.2024**

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.